

Research Article

Influence of Contemporary Strategies in Improving Reading Skills of Pupils of Class I-Iii

Edita Haxhijaha

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", Gjakovë

Article History

Received: 06.08.2020

Accepted: 23.09.2020

Published: 30.08.2020

Journal homepage:

<https://www.easpublisher.com/easjpbs>

Quick Response Code



Abstract: Reading is the most important skill that you need to develop each child at school. Children who don't have good reading skills at elementary level is more likely that in the future have limited education progress and limited economic opportunities and development. The aim of this study is to document performance of early grade student's performance in the field of reading, in order to understand the learning and needs for improvements, through application of contemporary methods and patterns as need and necessity for enhancing the quality of education in general and school students in particular. In terms of the progress, improvement of teaching practice, as a methodology of this study, we have used the research in action. First of all, because through this the problem situations and the practical concerns of the teachers were solved and second of all, it was a good opportunity to change the teaching practice and then to present evidence showing in what way this practice has been improved. The research was conducted in five PLSS in Prizren, in the first, second and third grades, where 200 students were tested over two different time periods to see the impact of contemporary methods and patterns implemented during that period of time, which was implemented in coordination with school directors, teachers and parents of students involved in the research. Based on the results obtained from our conducted research analysis we conclude that our research hypotheses were verified, as during the second test the students gave positive results and this showed that the use of modern methods and patterns positively contributed to the improvement of reading skills to class I-III students. Our research also showed that teachers are willing to seek for more advanced practices that bring positive results to students. With the use of a variety of methods and strategies, as well as with the continuous parent-teacher-school collaboration, we have achieved positive changes in the success of students. The obtained results had a double impact; in one hand, the improvement of student outcomes was satisfactory, and also the research had an impact on the professional development of teachers.

Keywords: *Students, teachers, reading, contemporary strategies, school institutions.*

Field: Social sciences

Copyright © 2020 The Author(s): This is an open-access article distributed under the terms of the Creative Commons Attribution **4.0 International License (CC BY-NC 4.0)** which permits unrestricted use, distribution, and reproduction in any medium for non-commercial use provided the original author and source are credited.

HYRJE

Librat janë të rëndësishëm. Ata përmbajnë njohuri dhe dije, siç është edhe thënia, janë pushtet. Librat janë arsyeja: ata janë kontenjerët, enët, konfrontimet. Ata mund të mësojnë, udhëzojnë, frymëzojnë, zbusin, dhe ngrisin zërin (Lyons & Rayner, 2016:2).

Leximi është proces i vendosjes së informatave të reja në mendje. Ai kërkon përqëndrim gjithëpërfshirës në mënyrë që të merren përvojat e reja. Ai është strukturë sipërfaqësore e gjuhës që nuk e paraqet kuptimin në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kuptimi qëndron në strukturën e thellë të gjuhës, në qëllimet e shkrimtarëve dhe në interpretimet e bëra nga lexuesit (Anisati, 2016:68). Gjatë leximit, është e nevojshme të interpretohen simbolet vizuale (p.sh. shkronjat, fjalët),

dhe të ndërlidhen këto simbole me fjalë (njësi leksikore) në leksikonin mendor. Ky proces njihet si njohja vizuale e fjalës (Wilson & Carroll & Werno, 2014:12).

Leximi aktiv do të thotë të kuptuarit të plotë të asaj që lexoni dhe përfshin të menduarit gjatë leximit (Patesan & Balagiu & Zechia & Alibec, 2014:66).

Leximi i vëmendshëm është më shumë se të zhvilluarit e avancuar të leximit; ai është një mekanizëm për të mësuar nxënësit me argumente logjike, duke kritikuar arsyetimin e të tjerëve, për të mbledhur dëshmi nga teksti (Rruka, 2016:14). Mësimi i leximit është një prej aftësive më të ndërlukuara për të mësuar. Nxënësit do të kenë sukses vetëm në fusha të tjera (dhe do ta bëjnë shprehje të jetës që të lexojnë për kënaqësi) nëse ata e kuptojnë se çka janë duke lexuar

duke përfshirë ndërtimin e një fjalori të gjerë, parashtrimi i pyetjeve, krijimi i lidhjeve dhe vizualizimi (21 anchor charts that teach reading comprehension, 2016:2).

Koha më e mirë për fëmijët që të fillojnë të lexojnë dhe të shkruajnë është kur ata janë shumë të rinj. Kjo është koha kur ata fillojnë të zhvillojnë sjellje pozitive dhe shkathtësitë fillestare. Të lexuarit fëmijëve dhe të folurit me ta për idetë e tyre (edhe nëse ato ide nuk kanë kuptim menjëherë) u ndihmon të arrijnë një nivel më të lartë të të kuptuarit (Map & Henderson, 2014:4).

Sipas Ivan Furlan nxënësi në fund të klasës së parë dhe në fillim të klasës së dytë duhet të lexojë për një minutë 50-70 fjalë (Pozhegu-Kumnova & Nixha, 2011:6).

Teknika e strategji bashkëkohore që mundësojnë lexim të rrjedhshëm

Germëzimi i emrit - Ushtrime germëzimi duke filluar nga fjalë të njohura (si p.sh. emri i nxënësit). Nxënësi e germëzon emrin e tij. *Hiqe tingullin* - Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të heqin tingullin e parë nga fjala që dëgjojnë dhe të tregojnë se si do të tingëllojë fjala, p.sh.: fjala *derë* do të bëhet *erë*, fjala *mik* do të bëhet *ik*, etj. Apo kërkohej që nxënësit të gjejnë se cili tingull është hequr nga fjala e caktuar.

Dora e pyetjeve - Nxënësit lexojnë tekstin e dhënë. Pas leximit parashtrojnë pyetje lidhur me tekstin në secilin gisht të dorës (të cilën e kanë vizatuar paraprakisht). Nxënësit i ndërrojnë fletët me pyetje dhe përgjigjen në pyetjet e shokut. Mund të vazhdohej me diskutim të përgjithshëm. Me qëllim të lexim-kuptimit, mund të përdoren edhe organizues të tjerë grafikë (si p.sh. korniza e tregimit, piramida, ylli etj).

Libri me tregime - Lexojmë një tregim të shkurtër. Nga tregimi i lexuar ndalemi në një fjalë. Nga fjalia përcaktohem në një fjalë. Fjalën e përcaktuar nxënësit e lexojnë shkronjë për shkronjë. Pastaj mund ta lexojnë edhe në rrokje. Nëse dëshironi, këtë aktivitet mund ta zgjeroni duke kërkuar nga nxënësit që t'i shkruajnë fjalët e lexuara. *Vazhdo tregimin* - Mësimdhënësi ose një nxënës e lexon një pjesë të tregimit me zë, ndërsa nxënësit tjerë e vazhdojnë tregimin sipas dëshirës. Këtë mund ta bëjnë me gojë apo në formë të shkruar (Xhaferi, 2014:43). Mësimdhënësit që punojnë me forma dhe metoda të reja mësimore, natyrisht, duhet të përgatisin dhe t'i punojnë materialet e nevojshme mësimore. Puna me forma dhe metoda të reja funksionon vetëm atëherë, kur më shumë mësimdhënës bashkërisht punojnë materiale të këtilla dhe ku secili ua jep edhe të tjerëve materialet e tij për përdorim. Për këtë arsye, puna me format dhe metodat e reja mësimore është punë ekipore (Siegfried Winkler, 2011:11).

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Duke synuar përparimin, përmirësimin e praktikës së mësimdhënies, si metodologji të këtij studimi kemi shfrytëzuar hulumtimin në veprim. "Hulumtimi në veprim është shqyrtimi sistematik i situatave profesionale, i cili ndërmerret nga vetë mësimdhënësit, me qëllim të përmirësimit të praktikave të tyre" (Elliott, 1991:69).

Objektivat e hulumtimit

- Të mundësohet njohja e koncepteve dhe teorive bashkëkohore të të lexuarit dhe njohërit t'u mundësohen mësimdhënësve strategji dhe teknika për ngritjen e shkathtësisë së leximit përmes praktikimit të tyre.
- Të verifikohen vështirësitë kryesore të nxënësve gjatë leximit.
- Të përmirësohen praktikat mësimore.

Hipotezat e hulumtimit

H.1 Nxënësit me të cilët zbatohen strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies tregojnë rezultate më të larta në shkathtësinë e leximit.

H.2 Ushtrimet e rregullta në baza ditore nëpërmjet bashkëpunimit prind-mësues-shkollë zhvillojnë leximin me ritëm, theks dhe intonacion që reflekton të folur të natyrshëm.

H.3 Planifikimi i pyetjeve të niveleve të ndryshme gjatë leximit përmirësojnë lexim-kuptimin te nxënësit e klasëve të hershme.

Mostra

Për mostër kemi caktuar nxënësit e klasëve I, II dhe të III-ta. Mostrën tonë e kanë përbërë gjithsej 200 nxënës të pesë SHFMU në Prizren (që është 10% i numrit të përgjithshëm të nxënësve në këto shkolla).

Përzgjedhja e këyre shkollave e klasëve është bërë për arsye se në këto shkolla mësueset e përfshira në hulumtim kanë përfunduar trajnimin e EGRA-s, njëkohësisht dhe shumë trajnime të tjera që kanë të bëjnë me njohjen e strategjive bashkëkohore, prandaj bashkëpunimi ynë që i suksesshëm.

Instrumentet e hulumtimit

Për mbledhjen e të dhënave kam shfrytëzuar teknikat kualitative: **Vrojtimi** - Përmes tij i kemi vrotuar nxënësit, sjelljet, emocionet, veprimet, si dhe përparimin e tyre gjatë hulumtimit. **Shënimet personale dhe ditarët** - Shfrytëzohen për të regjistruar idetë dhe vëzhgimet në lidhje me veprimet. Mbajtja aktive e shënimeve zakonisht çon jo vetëm në një grup të dobishëm shënimesh, por edhe në një rikujtim të mirë të vetë ngjarjes (Matthews & Ross, 2010:194). **Punimet e nxënësve** - Shembuj nga punimet e nxënësve gjithashtu janë burime shumë të mira për të siguruar informacione konkrete dhe në mënyrë vizuale. Gjithashtu kemi shfrytëzuar edhe teknika kuantitative. **Testet e standardizuara** - EGRA është test i leximit për klasat I-III. Është test individual.

Testimi i një fëmije bëhet për rreth 10-12 minuta. Mësimdhënësi mund të administrojë kombinime të ndryshme të nëntesteve, varësisht nga gjykimi i tij për nevojat e nxënësve.

Metodat e hulumtimit shkencor

Metoda: Shqyrtim literature - Nëpërmjet kësaj metode jemi munduar të shqyrtojmë punime të ndryshme shkencore-profesionale në fushën e leximit.
Metodat e përziera - Janë kombinim i metodave sasiore dhe cilësore në mënyrën që i përshtatet më mirë studimit.

Në mënyrë që të dhënat e mbledhura të analizohen në mënyrë efikase, me qëllim të maksimizimit të vlerës së informacionit, ne kemi përdorur softuerin: Social Package for the Social Sciences (SPSS) i krijuar nga kompania e mirënjohur e teknologjisë informative IBM. Përparësia e tij kryesore është aftësia e tij për të mundësuar gjetjen e çdo lloj marrëdhënieje në mes të elementeve të një pyetësi, gjë që është shumë e vështirë të realizohet në forma tjera, e që për këtë hulumtim ka rëndësi të madhe duke pasur parasysh që po tentohet të përcaktohen faktorët të cilët influencojnë rezultatet e nxënësve në faktorët e përfshirë në testin EGRA.

Analiza e të dhënave

REZULTATET E HULUMTIMIT

Tabela 1. Rezultatet e EGRA-s në të dy kohët e testimit sipas shkollës

Faktori	Shkolla	Testimi I			Testimi II			Përqindja e rritjes
		N	Mean	Std. Deviation	N	Mean	Std. Deviation	
Vetëdija tingullore	Emin	40	8.57	1.5172	40	9.65	1.3311	14.45%
	Duraku							
	Loyola	40	8.32	1.3280	40	9.77	.5305	19.81%
	Abdyl	40	8.97	1.0739	39	9.87	.4091	11.06%
	Frashëri							
	Mati	40	9.20	1.0908	40	9.95	.2207	9.73%
	Logoreci							
	Lekë	40	8.45	1.8109	40	9.75	.5883	23.81%
Njohja e emrit dhe tingullit të shkronjës	Dukagjini							
	Total	200	8.70	1.4170	199	9.79	.7246	15.798%
	Emin	40	83.30	10.0389	40	93.07	5.3224	12.72%
	Duraku							
	Loyola	40	84.75	8.7082	40	91.72	9.3425	8.75%
	Abdyl	40	82.32	12.1811	39	92.97	6.3473	14.83%
	Frashëri							
	Mati	40	86.22	7.8984	40	95.87	4.5415	11.71%
Leximi i fjalëve të njohura	Logoreci							
	Lekë	40	77.22	14.1303	40	90.05	7.1395	20.62%
	Dukagjini							
	Total	200	82.76	11.1585	199	92.73	6.9495	13.72%
	Emin	40	42.20	7.3735	40	46.90	3.8284	13.80%
	Duraku							
	Loyola	40	42.60	4.6232	40	48.05	7.8804	13.97%
	Abdyl	40	43.62	6.2458	39	47.17	3.4172	9.80%
Leximi i fjalëve të panjohura	Frashëri							
	Mati	40	42.80	5.5108	40	47.57	3.2097	12.28%
	Logoreci							
	Lekë	40	37.80	9.9181	40	44.17	5.5833	23.80%
	Dukagjini							
	Total	200	41.80	7.2088	199	46.77	5.2334	14.75%
	Emin	40	38.35	8.3006	40	42.80	5.3980	15.29%
	Duraku							
Leximi i fjalëve të panjohura	Loyola	40	37.20	6.6108	40	44.02	9.6383	20.19%
	Abdyl	40	38.10	9.0661	39	43.41	4.9668	20.82%
	Frashëri							
	Mati	40	38.37	6.5855	40	44.52	4.0635	18.283%
	Logoreci							
	Lekë	40	32.97	10.7905	40	39.37	7.5369	29.70%
	Dukagjini							
	Total	200	37.00	8.5877	199	42.82	6.8235	20.86%

Rrjedhshmëria e leximit me zë	Emin	30	58.20	2.6961	30	62.53	1.9605	7.55%
	Duraku							
	Loyola	30	57.76	1.5466	30	62.70	1.2360	8.57%
	Abdyl	30	54.70	10.7291	29	60.69	6.1185	15.43%
	Frashëri							
	Mati	34	57.02	5.3625	30	63.10	1.4227	9.15%
	Logoreci							
	Lekë	30	54.90	9.2414	30	61.56	5.5689	15.26%
Të kuptuarit	Dukagjini							
	Total	154	56.53	6.9368	149	62.12	3.9203	11.16%
	Emin	30	2.10	1.1847	30	3.46	1.2521	80.35%
	Duraku							
	Loyola	30	1.86	1.4559	30	3.30	1.1788	82.97%
	Abdyl	30	1.63	1.3767	29	3.41	1.1186	77.91%
	Frashëri							
	Mati	34	2.47	1.3081	30	4.16	.7915	88.79%
Nxënia (të kuptuarit) përmes dëgjimit	Logoreci							
	Lekë	30	1.50	1.1671	30	3.06	1.0807	107.60%
	Dukagjini							
	Total	154	1.92	1.3339	149	3.48	1.1426	87.53%
	Emin	30	2.23	1.3566	30	3.46	1.1366	85.05%
	Duraku							
	Loyola	30	1.70	1.1188	30	3.30	1.0222	111.01%
	Abdyl	30	2.00	1.4622	29	3.20	1.0816	73.26%
Diktim	Frashëri							
	Mati	34	2.58	1.3510	30	4.13	.7761	96.26%
	Logoreci							
	Lekë	30	1.83	1.1769	30	2.73	1.2299	59.87%
	Dukagjini							
	Total	154	2.08	1.3233	149	3.36	1.1411	85.70%
	Emin	30	16.60	1.6526	30	17.60	1.0034	6.81%
	Duraku							
Loyola	30	16.30	1.6846	30	17.733	.5833	9.74%	
Abdyl	30	16.16	1.7633	29	17.34	1.0098	7.98%	
Frashëri								
Mati	34	15.47	2.0484	30	17.13	1.5477	11.3%	
Logoreci								
Lekë	30	15.33	1.9535	30	16.83	1.4404	10.75%	
Dukagjini								
Total	154	15.96	1.8748	149	17.32	1.1993	9.3%	

Në vijim do të përshkruaj rezultatet e fituara gjatë testimit të nxënësve përmes testit A-EGRA brenda dy periudhave kohore, njëkohësisht do të nxjerr në pah se nxënësit e cilës shkollë kanë treguar rezultate më të mira. Nga secila shkollë janë testuar nga 40 nxënës, që do të thotë gjithsej u testuan 200 nxënës.

Në rreshtin e parë të tabelës mund të lexohen rezultatet për faktorin *Vetëdija tingullore*, të paraqitura sipas shkollës, aty mund të shihet se nuk ka diferencë të dukshme në saktësinë e përgjigjeve në mes të shkollave të përfshira në këtë studim, por shihen dallime të vogla nga shkolla në shkollë. Sa i përket përqindjes së rritjes së përgjigjeve të sakta, shkolla me përqindjen më të madhe të rritjes është shkolla *Lekë Dukagjini* me 23.81% rritje, pastaj shkolla *Loyola* me 19.81% rritje, *Emin Duraku* e cila ka përmirësuar rezultatit me 14.45% e ndjekur nga shkolla *Abdyl Frashëri* me 11.81%, dhe shkolla me rritjen më të vogël sa i përket

faktorit *Vetëdija tingullore* është shkolla *Mati Logoreci* me 9.73% rritje.

Vërejmë se nga 200 nxënës të testuar në pesë SHFMU në Prizren, komponenti i vetëdijes tingullore ishte më i suksesshëm te nxënësit e shkollës *Mati Logoreci*, të cilët arritën të ndajnë saktë më shumë fjalë në tinguj.

Në rreshtin e dytë të tabelës mund të lexohen rezultatet për faktorin *Njohja e emrit dhe tingullit të shkronjës*, të paraqitura sipas shkollës. Renditja e shkollave përmes përqindjes së rritjes së përgjigjeve të sakta është ajo me rritje më të madhe, shkolla *Lekë Dukagjini* me 20.62%, *Abdyl Frashëri* me 14.83% rritje, *Emin Duraku* e cila ka përmirësuar rezultatit me 12.72% e ndjekur nga shkolla *Mati Logoreci* me 11.71%, dhe me rritjen më të vogël është shkolla *Loyola* me 8.75% rritje.

Te nëntesti *Leximi i fjalëve të njohura*, mund të shihet se shkolla me përqindjen më të madhe të rritjes është shkolla *Lekë Dukagjini* me 23.80% rritje, *Loyola* me 23.80%, *Emin Duraku* me 13.80%, *Mati Logoreci* me 12.28%, dhe shkolla me rritjen më të vogël është *Abdyl Frashëri* me 9.80% rritje.

Leximi i fjalëve të panjohura jep përqindjen më të madhe të rritjes në shkollën *Lekë Dukagjini* me 29.70% rritje, *Abdyl Frashëri* 20.82%, *Loyola* 20.19%, *Mati Logoreci* 18.28% dhe *Emin Duraku* me 15.29% rritje.

Te nëntesti *Rrjedhshmëria e leximit me zë* nga shkolla me përqindjen më të madhe të rritjes është shkolla *Abdyl Frashëri* me 15.43% rritje, *Lekë Dukagjini* 15.26%, *Mati Logoreci* 9.15%, *Loyola* 8.57%, dhe *Emin Duraku* me 7.55% rritje.

Shkolla me përqindjen më të madhe të rritjes te nëntesti *Të kuptuarit* është shkolla *Lekë Dukagjini* me 107.60% rritje, *Mati Logoreci* 88.79%, *Loyola* 82.97%, *Emin Duraku* 80.35% dhe *Abdyl Frashëri* me 77.91% rritje.

Përqindja më e madhe e rritjes në faktorin *Nxënia (të kuptuarit) përmes dëgjimit* i takon shkollës *Loyola* me 111.01% rritje, *Mati Logoreci* 96.26%, *Emin Duraku* 85.05%, *Abdyl Frashëri* 73.26% dhe *Lekë Dukagjini* me 59.87% rritje.

Në nëntestin e fundit *Diktimi*, shkolla me përqindjen më të madhe të rritjes ishte *Mati Logoreci* me 11.3% rritje, *Lekë Dukagjini* 10.75%, *Loyola* 9.74%, *Abdyl Frashëri* 7.98% dhe *Emin Duraku* me 6.81% rritje.

DISKUTIMI

Mbështetur në rezultatet e fituara nga analizat e zhvilluara vijmë në përfundim se hipotezat tona të hulumtimit u verifikuan. Kjo u dëshmuar pasiqë nxënësit u testuan dy herë me testin EGRA. Testimi i parë pasqyroj gjendjen aktuale se si e kishin nxënësit në raport me leximin, derisa testimi i dytë tregoi rezultatet e përmirësuar, gjegjësisht ndikimin pozitiv që patën strategjitë e mësimdhënies. Bashkëpunimi ynë i vazhdueshëm ndikoi pozitivisht në përmirësimin e shkathhtësisë së leximit të nxënësit. Shumica e shkollave të përfshira në hulumtim janë ndërtuar vitet e fundit, kanë një standard tjetër, ndriçim të mirë, hapësirë të madhe, janë të pajisura me laptop, projektor, me mjaft mjete konkretizimi, shkollë bashkëkohore e cila na e lehtësoi punën tonë gjatë kryerjes së hulumtimit dhe na dha rezultate pozitive. Përgatitja e kuadrit profesional, zbatimi i teknikave adekuate gjatë orëve mësimore, angazhimi maksimal, mundësuan vërtetimin e hipotezave.

KONKLUKIME DHE REKOMANDIME

Konkludime

Hulumtimi në veprim që u realizua ka dhënë rezultatet e pritura dhe ka rritur interesimin së pari të prindërve që të jenë më të angazhuar me fëmijët e tyre, pastaj të mësimdhënësve që të njohin mirë procesin e të lexuarit si edhe një mësimdhënie efektive që t'i aftësojë nxënësit të bëhen lexues të mirë, aktivë gjatë gjithë jetës së tyre, t'i bëjë ata të aftë për t'u përfshirë në mënyrë të pavarur në veprimtarinë lexuese.

Rekomandime

Gjetjet e punimit kanë implikimet e tyre praktike, prandaj më poshtë po rendisim disa rekomandime konkrete:

Rekomandime për drejtoritë e shkollave:

- Të sigurojnë që të gjithë mësimdhënësit të marrin pjesë në trajnime për të pasur qasje në teknikat adekuate që përmirësojnë shkathhtësinë e leximit.

Rekomandime për mësimdhënësit:

- Ta kuptojnë më mirë procesin e të lexuarit dhe komponentët e tij;
- Të jenë më të vetëdijshëm mbi kërkesat për një mjedis të këndshëm për lexim si në shkollë ashtu edhe në shtëpitë e nxënësve;
- Të krijojnë praktika të bashkëpunimit ndërmjet prindërve dhe mësimdhënësve në baza të rregullta kohore, në të cilat takime të diskutohen, ndahen informacione, ofrohen materiale e udhëzime për të lehtësuar punën e përbashkët të prindërve dhe mësimdhënësve në lehtësimin e të nxënësve të fëmijëve;

Rekomandime për prindërit:

- Të kenë shumë libra përreth dhe t'i lejojnë fëmijët t'i shohin duke lexuar dhe duke u kënaqur gjatë leximit;
- T'i dërgojnë fëmijët shpesh në bibliotekë/librari, t'i lejojnë të hulumtojnë dhe t'i zgjedhin librat për vete;
- T'i diskutojnë librat dhe tregimet që i lexojnë, qoftë së bashku apo vetë.

Falënderime

Realizimi i këtij punimi nuk do të ishte i mundur pa këshillat, mbështetjen dhe bashkëpunimin nga shumë individë. Mirënjohje të përzemërt e të pakufijshme për drejtorët e institucioneve shkollore, mësimdhënësit, nxënësit e prindërit e tyre, që morën pjesë në këtë hulumtim, për gatishmërinë, bashkëpunimin dhe mbështetjen profesionale gjatë zhvillimit të hulumtimit. Mirënjohje pafund për familjen time, në veçanti për prindërit e mi, për dashurinë dhe mbështetjen e tyre të pakushtëzuar.

LITERATURA

1. 21 anchor charts that teach reading comprehension, <http://www.weareteachers.com/21-anchor-charts-that-teach-reading-comprehension/> accessed: 12.12.2016.
2. Anisati, Y. (2016, March). "The matters in teaching reading comprehension to EFL Students" *Studies in English Language and Education*, Vol. 3, no.1, p.68.
3. APA (1994). American Psychiatric Association, Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders, -4th ed. American Psychiatric Association. Washington, D.C.
4. Elliott, J. (1991): Action research for educational change. Buckingham: Open University Press.
5. Lyons, R. E., & Rayner, S. (2016). "Introduction: The academic book of future" *The academic book of future*, p.2.
6. Map, K... & Henderson, A. (2014). "Reading and writing with your child. Kindergarten to Grade 6: Parent Guide", Ontario Ministry of Education, p.4.
7. Mathews, B., & Ross, L. (2010). *Metodat e hulumtimit*. (Përkthyer nga Majlinda Nishku & Ilir Nishku). Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë.
8. Patesan, M., & Balagiu, A., & Zechia, D., & Alibec, C. (2014). "Critical reading", *Buletin Stiintic*, no.1 (37), p.66.
9. Pozhegu-Kumnova, S., & Nixha, Dh. (2011). *Shpejtësia e të lexuarit në klasën e parë*. Prishtinë.
10. Rruka, V. (2016). *Motivimi i nxënësve për të lexuar, në kontekst të vetë konceptit si lexues dhe vlerave që i kanë për leximin*. Prizren, Kosovë.
11. Stenhouse, L. (1985): *Research as a Basis for Teaching* (botur nga Rudduck, J./Hopkins, D.). London: Heinemann.
12. Wilson, F., & Carroll, P., & Werno, M. (2014). "Not dumbing down but stimulating up: Reading in the reformed GCSE modern foreign languages classroom", Cambridge Assessment, University of Cambridge, p.12.
13. Xhaferi, J. (2014, Maj). *Vlerësimi i leximit në klasat e hershme (A-EGRA)*. Basic Education Program. USAID Kosovë.